



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2020:100734
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05603754

K.Dh.Sh.II.nr.1132/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Comtrade Computers” O.K me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1382/2020 të datës 07.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “Comtrade Computers” O.K me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1382/2020, i datës 07.02.2022, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1382/2020, të datës 07.02.2022, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe ka mbetur në fuqi vendimi nr.75/2020 i datës 07.07.2020 i Divizionit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të: vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike me propozimin që kjo gjykatë ta aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar, ta anuloj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1382/20 i datës 15.02.2022, të anuloj plotësisht vendimin e Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës me nr.Prot.75/2020 të datës 07.07.2020, dhe të aprovoj kthimin e mjeteve financiare të paguara në emër të ndëshkimeve për mos pagesë të kontributeve pensionale për ortakët e ortakërisë Comtrade Computers O.K, për periudhën 2011 dhe 2012. Mjete financiare të ndaluara padrejtësisht në emër të ndëshkimeve të na kthej në llogarinë bankare nr.1501001000872413.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me vendimin nr.75/2020, të datës 07.07.2020, ka refuzuar si të pabazuar ankesën në riprocedurë sipas Aktgjykimit A.nr.989/17 (protokolluar në Divizionin e Ankesave me nr.75/2020) për subjektin “Comtrade Computers” OK me numër Unik Identifikues (NUI) me bashkëpunëtor z.E.D. dhe z.A.D., me seli të biznesit në adresën Rr.”Eqrem Qabej” P.n – Prishtinë, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 “Për Procedurën Administrative” në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr.03/L-222 ‘Për Administratën Tatimore dhe Procedurat’. Njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë ta caktuara me kontroll janë vërtetuar si të bazuara.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 21.08.2020, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.75/2020, të datës 07.07.2020, të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar ka theksuar se Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t’i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi. Gjykata ka shqyrtuar pretendimin e paditësit se nga inspektori tatimor përmes dëshmisë nr.4 i është rekomanduar ndërrimi i formës së deklarimit i cili ndërrim e ka pamundësuar pagesën e kontributeve pensionale për ortak, pasi që forma e rekomanduar e deklarimit nga inspektori tatimor i përshtatet shoqërive tjera tregtare e jo ortakërisë. Nga dëshmia nr.4, përkatësisht dokumenti shënim mbi aktivitetin e inspektorit i datës 17.09.2010, gjykata vëren se inspektori tatimor ka konstatuar që paditësi tatimin në ortakëri e ka deklaruar në tatim në të ardhura individuale dhe e ka udhëzuar paditësin që të bëjë korrigjimet e deklaratave nëpër periudhat tatimore në bazë të legjislacionit në fuqi. Prandaj, nga ky konstatim i inspektorit, gjykata vlerëson se paditësi ka qenë i obliguar që të bëjë korrigjimin e deklaratave dhe të bëjë deklaratimet në mënyrë të drejtë, prandaj mos deklarimi i tatimit nga ana e paditësit është në

kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe rrjedhimisht është i drejtë konstatimin i vendimit kontestues se paditësi ka qenë i obliguar sipas ligjit 03/L-16 për TAP dhe ligjit 04/L-101 për Pensionet në Kosovë, të bëjë deklarinimin dhe pagesën e tatimeve dhe kontributeve pensionale. Paditësi nuk ka arritur të dëshmojë se përmes ndonjë veprimi ka bërë përpjekje për deklarimin e drejtë të tatimit dhe kontributeve pensionale për ortakët e kufizuar, prandaj gjykata e vlerëson si të drejtë arsyetimin e vendimit kontestues që nenin 43 paragrafi 114 në lidhje me paragrafin 113 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 parasheh se nuk mund të ketë lehtësim nga ndëshkimi i vendosur për mos mbajtje në burim apo mos pagesën e kontributeve pensionale.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejtë ankesën e tatimpaguesit, nga fakti se nuk janë marrë për bazë pretendimet ankimore, dëshmitë dhe shpjegimet e ofruara nga tatimpaguesi në ankesën e tij, për kolegjin e kësaj gjykate janë të pabazuara për faktin se Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se për çështjen e konfliktit administrativ gjykata vendos në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 i LKA-së, dhe ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore, dëshmitë dhe shpjegimet e ofruara nga paditësi në padinë e tij.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa, e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadiisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një

aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1132/22, me datë 22.04.2024

Kryetar i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova